

32001L0017

Direktiva 2001/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 19 mars 2001, për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve

Gazeta Zyrtare L 110, 20/04/2001 fq. 0028-0039

Direktiva 2001/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit,

datë 19 mars 2001. për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 47 paragrafi 2 dhe nenin 55 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2),

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit (3),

Duke pasur parasysh:

(1) Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e aktive ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (4) e plotësuar me Direktivën 92/49/KEE(5) dhe Direktivën e parë të Këshillit 79/267/KEE, datë 5 mars 1979, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë të jetës (6), e plotësuar me Direktivën 92/96/KEE (7), parashikojnë një autorizim të vetëm të ndërmarrjeve të sigurimeve të dhënë nga autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar të origjinës. Ky autorizim i vetëm i lejon së ndërmarrjes sigurimeve të ushtrorë veprimtari në Komunitet nëpërmjet vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime pa asnjë autorizim tjetër nga Shteti Anëtar pritës dhe nën mbikëqyrjen e vetme të autoriteteve mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës .

(2) Direktivat për sigurimet ku parashikohet një autorizim i vetëm me objekt Komunitetin për ndërmarrjet e sigurimeve nuk përmbajnë rregulla bashkërendimi në rastin e procedurave të likuidimit. Ndërmarrjet e sigurimeve si dhe institucionet e tjera financiare përjashtohen shprehimisht nga fusha e veprimit e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1346/2000, datë 29 maj 2000, për procedurën e falimentimit (8). Është në interesin e funksionimit të duhur të tregut të brendshëm dhe të mbrojtjes së kreditorëve që të vendosen rregulla të bashkërenduara sipas standardeve të Komunitetit për procedurën e likuidimit në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve.

(3) Është mirë të vendosen rregulla për bashkërendimin edhe për të siguruar që masat e riorganizimit, të miratuara nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar me qëllim që të ruhet ose të rivendoset qëndrueshmëria financiare e një ndërmarrjeje sigurimesh dhe të parandalohet,

në masën e duhur, situata e likuidimit, të japin efekt të plotë në të gjithë Komunitetin. Masat e riorganizimit të mbuluara nga kjo direktivë janë ato që ndikojnë mbi të drejtat paraekzistuese të palëve të ndryshme nga vetë ndërmarrja e sigurimeve. Masat e parashikuara në nenin 20 të Direktivës 73/239/KEE dhe nenin 24 të Direktivës 79/267/KEE është mirë të përfshihen në fushëveprimin e kësaj direktive, me kusht që ato të përputhen me kushtet e parashikuara në përkufizimin e masave të riorganizimit.

(4) Kjo direktivë zbatohet në të gjithë Komunitetin, fusha e veprimit e së cilës ndikon tek ndërmarrjet e sigurimeve sipas përkufizimit në Direktivat 73/239/KEE dhe 79/267/KEE që e kanë zyrën qendrore në Komunitet, tek degët brenda Komunitetit të ndërmarrjeve të sigurimeve që e kanë zyrën qendrore në vende të treta dhe tek kreditorët me vendbanim në Komunitet. Kjo direktivë nuk rregullon efektet e masave të riorganizimit dhe procedurave të likuidimit kundrejt vendeve të treta.

(5) Kjo direktivë është mirë të ketë të bëjë me procedurat e likuidimit, pavarësisht nëse bazohen në paaftësinë paguese dhe nëse ato janë të detyrueshme apo vullnetare. Është mirë që kjo direktivë të zbatohet për procedurat kolektive sipas përkufizimit të legjislacionit të Shteteve Anëtare të origjinës në përputhje me nenin 9 që ka të bëjë me konvertimin e aktiveve të ndërmarrjes së sigurimeve dhe me shpërndarjen e të ardhurave nga shitja e tyre. Procedurat e likuidimit të cilat, edhe nëse nuk bazohen në paaftësinë paguese, e përfshijnë e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve sipas rendit të përparësisë në përputhje me nenin 10, është mirë të përfshihen gjithashtu në fushëveprimin e kësaj direktive. Të drejtat e kërkuara nga punonjësit e ndërmarrjeve të sigurimeve që rrjedhin nga kontratat e punësimit dhe marrëdhëniet e punës është mirë të mund t'i kalohen një skeme kombëtare për garantimin e pagave; këto pretendime të kaluara është mirë të përfitojnë nga trajtimi i përcaktuar nga ligji i Shtetit Anëtar të origjinës (lex concursus) sipas parimeve të kësaj direktive. Është mirë që dispozitat e kësaj direktive të zbatohen për rastet e ndryshme të procedurës së likuidimit, sipas rastit.

(6) Miratimi i masave të riorganizimit nuk përjashton hapjen e procedurës së likuidimit. Procedurat e likuidimit mund të hapen në mungesë të ose pas miratimit të masave të riorganizimit dhe ato mund të përfundojnë me marrëveshje ose masa të tjera të ngjashme, duke përfshirë masat e riorganizimit.

(7) Përkufizimi i degës, në përputhje me parimet ekzistuese të paaftësisë paguese, është mirë të marrë parasysh personalitetin e vetëm juridik të ndërmarrjes së sigurimeve. Legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës është mirë të përcaktojë mënyrën se si duhen trajtuar gjatë likuidimit të ndërmarrjes së sigurimeve aktivet dhe pasivet që mbahen nga persona të pavarur të cilët kanë autoritet të përhershëm për të vepruar si agjentë për një ndërmarrje sigurimesh.

(8) Është mirë të bëhet dallimi ndërmjet autoriteteve kompetente për qëllimet e masave të riorganizimit dhe procedurën e likuidimit dhe autoriteteve mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të sigurimeve. Autoritetet kompetente mund të jenë autoritete administrative ose gjyqësore, në varësi të legjislacionit të Shtetit Anëtar. Kjo direktivë nuk ka si synim harmonizimin e

legjislacionit të brendshëm në lidhje me caktimin e kompetencave ndërmjet këtyre autoriteteve.

(9) Kjo direktivë nuk ka si synim harmonizimin e legjislacionit të brendshëm në lidhje me masat e riorganizimit dhe procedurën e likuidimit, por synon sigurimin e njohjes reciproke të masave të riorganizimit dhe legjislacionit të likuidimit të Shteteve Anëtare në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve si dhe bashkëpunimin nevojshëm. Një njohje e tillë reciproke zbatohet në këtë direktivë nëpërmjet parimeve të unitetit, gjithshmërisë, bashkërendimit, publicitetit, trajtimit të barasvlershëm dhe mbrojtjes së kreditorëve të sigurimeve.

(10) Është mirë që tagri për marrjen e vendimeve për procedurat e likuidimit në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve ta kenë vetëm autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës (parimi i unitetit). Këto procedura duhet të kenë efektet e tyre në të gjithë Komunitetin dhe duhet të njihen nga të gjitha Shtetet Anëtare. Është mirë që gjatë procedurës së likuidimit, si rregull i përgjithshëm, të merren në konsideratë të gjitha aktivet dhe pasivet e ndërmarrjes së sigurimeve (parimi i universalitetit).

(11) Është mirë që legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës pritës të rregullojë vendimin e likuidimit në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve, vetë procedurën e likuidimit dhe efektet e saj, qofshin lëndore apo procedurale, për personat dhe marrëdhëniet juridike përkatëse, përveç kur kjo direktivë parashikon ndryshe. Kështu të gjitha kushtet për hapjen, zhvillimin dhe mbylljen e procedurës së likuidimit është mirë të rregullohen përgjithësisht nga ligji i Shtetit Anëtar të origjinës. Me qëllim që të lehtësohet zbatimi i saj, është mirë që kjo direktivë të përfshijë një listë joshteruese të aspekteve të cilat i nënshtrohen veçanërisht rregullit të përgjithshëm të legjislacionit të Shtetit Anëtar të origjinës.

(12) Autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës dhe ato të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare është mirë të informohen urgjentisht për hapjen e procedurës së likuidimit (parimi i bashkërendimit).

(13) Është e një rëndësie themelore që personat e siguruar, policëmbajtësit, përfituesit dhe çdo palë e dëmtuar me të drejtë pretendimi të drejtpërdrejtë kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve të lindur nga operacionet e sigurimeve, të jenë të mbrojtur në procedurën e likuidimit. Kjo mbrojtje nuk duhet të përfshijë pretendimet që nuk rrjedhin nga detyrimet sipas kontratave të sigurimeve ose operacioneve të sigurimeve, por nga përgjegjësia civile e shkaktuar nga një agjent gjatë negociatave për të cilën, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për kontratën ose operacionin e sigurimeve, vetë agjenti nuk është përgjegjës sipas kësaj kontrate ose operacioni të sigurimeve. Për ta arritur këtë objektiv, është mirë që Shtetet Anëtare të garantojnë trajtim të veçantë për kreditorët e sigurimeve në përputhje me një prej metodave fakultative të parashikuara në këtë direktivë. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin ndërmjet dhënies precedencë absolute dëmeve të sigurimeve kundrejt pretendimeve të tjera në lidhje me aktivet që përfaqësojnë provigjonet teknike ose dhënies e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve një rang të veçantë mbi të cilin mund të vijjnë vetëm pretendimet për pagat, sigurimet shoqërore, tatimet dhe të drejtat reale për të gjitha aktivet e ndërmarrjes së sigurimeve. Asnjëra prej dy metodave e parashikuara në këtë direktivë nuk e

pengon Shtetin Anëtar që të vendosë një listë prioriteti ndërmjet kategorive të ndryshme të kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve .

(14) Është mirë që kjo direktivë të sigurojë një drejtpeshim të duhur ndërmjet mbrojtjes së kreditorëve të sigurimeve dhe kreditorëve të tjerë të privilegjuar të mbrojtur nga legjislacioni i Shteteve Anëtare dhe jo të harmonizojë sistemet e ndryshme të kreditorëve të privilegjuar që ekzistojnë në Shtetet Anëtare.

(15) Dy metodat fakultative për trajtimin e e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve konsiderohen në thelb të barasvlershme. Metoda e parë garanton vendosjen e aktiveve që përfaqësojnë provigjonet teknike në dispozicion të e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve, ndërsa metoda e dytë u garanton kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve një pozicion në renditjen e kreditorëve që prek jo vetëm aktivet që përfaqësojnë provigjonet teknike, por të gjitha aktivet e ndërmarrjes së sigurimeve.

(16) Shtetet Anëtare të cilat, me qëllim që të mbrojnë kreditorët e sigurimeve, zgjedhin metodën e dhënies së përparësi absolute kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve në lidhje me aktivet që përfaqësojnë provigjonet teknike duhet t'u kërkojnë ndërmarrjeve të tyre të sigurimeve të krijojnë dhe të mbajnë të përditësuar një regjistër të veçantë me këto aktive. Një regjistër i tillë është një instrument për identifikimin e aktiveve që përdoren për këto pretendime.

(17) Me qëllim që të fuqizohet barasvlershmëria ndërmjet të dy metodave të trajtimit të të kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve, është mirë që kjo direktivë t'i detyrojë Shtetet Anëtare që zbatojnë metodën e parashikuar në nenin 10 pika 1 shkronja "b" t'i kërkojnë çdo ndërmarrjeje të sigurimeve të paraqesin, në çdo moment dhe pavarësisht nga një likuidim i mundshëm, pretendimet të cilat sipas kësaj metode mund të kenë përparësi kundrejt kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve dhe që janë regjistruar në llogaritë e ndërmarrjeve të sigurimeve, me anë të aktiveve të cilat lejohen nga direktivat e sigurimeve në fuqi të përfaqësojnë provigjonet teknike.

(18) Shteti Anëtar i origjinës është mirë të jetë në gjendje të parashikojë që nëse të drejtat e kreditorëve të sigurimeve i janë transferuar në skeme garancie të ngritur në këtë Shtet Anëtar vendas, pretendimet nga kjo skemë të mos përfitojnë nga trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve sipas kësaj direktive.

(19) Hapja e procedurës së likuidimit është mirë të përfshijë tërheqjen e autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë tregtare që i është dhënë ndërmarrjes së sigurimeve, përveç kur ky autorizim është tërhequr më parë.

(20) Vendimi për hapjen e procedurës së likuidimit, i cili mund të ketë efekte në të gjithë Komunitetin sipas parimit të universalitetit, duhet të bëhet e ditur në mënyrë të përshtatshme brenda Komunitetit. Me qëllim që të mbrohen interesat e palëve, vendimi është mirë të publikohet në përputhje me procedurat e Shtetit Anëtar i origjinës dhe në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane dhe, për më tepër, me çdo mjet tjetër të vendosur nga autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare brenda territoreve të tyre përkatëse. Përveç publikimit të

vendimit, kreditorët e njohur me vendbanim në Komunitetet është mirë të njoftohen individualisht për vendimin dhe ky informacion të përmbajë të paktën elementët e specifikuar në këtë direktivë. Likuidatorët duhet t'i mbajnë gjithashtu kreditorët të informuar rregullisht mbi ecurinë e procedurës së likuidimit.

(21) Kreditorët duhet të kenë të drejtën të ngrenë pretendime ose të paraqesin vërejtje me shkrim në procedurën e likuidimit. Pretendimet e kreditorëve me vendbanim në Shtetin Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i origjinës është mirë të trajtohen në të njëjtën mënyrë si pretendimet e barasvlershme në Shtetin Anëtar vendas pa asnjë diskriminim për shkak të shtetësisë ose vendbanimit (parimi i trajtimit të barasvlershëm).

(22) Është mirë që kjo direktivë të zbatohet për masat e riorganizimit të miratuara nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar parime të cilat të jenë të ngjashme, me përshatjet sipas rastit, me ato të parashikuara për procedurën e likuidimit. Publikimi i këtyre masave të riorganizimit është mirë të kufizohet në kuptimin që të përdoren vetëm për rastet kur mund të bëhet ankim në Shtetin Anëtar të origjinës nga palë të tjera përveç vetë ndërmarrjes së sigurimeve. Nëse masat e riorganizimit ndikojnë ekskluzivisht mbi të drejtat e aksionarëve, ortakëve ose punonjësve të një ndërmarrjeje sigurimesh të konsideruara me këto cilësi, është mirë që autoritetet kompetente të përcaktojnë mënyrën në të cilën palët e interesuara të informohen në përputhje me legjislacionin përkatës.

(23) Kjo direktivë parashikon rregulla të bashkërenduara për të përcaktuar legjislacionin e zbatueshëm për masat e riorganizimit dhe procedurën e likuidimit të ndërmarrjeve të sigurimeve. Kjo direktivë nuk përpiqet të vendosë rregulla të së drejtës ndërkombëtare private që përcakton legjislacionin e zbatueshëm për kontratat ose marrëdhëniet e tjera juridike. Veçanërisht, kjo direktivë nuk synon të rregullojë rregullat e zbatueshme për ekzistencën e një kontrate, të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe vlerësimin e borxheve.

(24) Rregulli i përgjithshëm i kësaj direktive, sipas të cilit masat e riorganizimit dhe procedura e likuidimit rregullohen nga legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës, është mirë të ketë një sërë përjashtimesh me qëllim që të mbrohet besimi legjitim dhe siguria e veprimeve të caktuara juridike në Shtetet Anëtare që nuk janë Shteti Anëtar i origjinës. Është mirë që këto përjashtime të kenë të bëjnë me efektet e këtyre masave të riorganizimit ose procedurave të likuidimit mbi kontrata dhe të drejta të caktuara, të drejtat reale të palëve të treta, ruajtja e titullit, kompensimet, tregjet e rregulluara, veprimet dëmtuese, blerësit si palë të treta dhe gjykimet e papërfunduara.

(25) Përjashtimi në lidhje me efektet e masave të riorganizimit dhe procedurat e likuidimit mbi kontrata dhe të drejta të caktuara të parashikuara në nenin 19 është mirë të parashikohet vetëm për efektet e specifikuar aty dhe të mos përfshijë asnjë çështje tjetër në lidhje me masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit si regjistrimi i procedurës, verifikimi, pranimi dhe renditja e pretendimeve në lidhje me kontratat dhe të drejtat, të cilat duhet të rregullohen nga legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës .

(26) Efektet e masave të riorganizimit dhe procedurës së likuidimit në një gjykim të papërfunduar është mirë të rregullohen nga ligji i Shteteve Anëtare në të cilët gjykimi është i

papërfunduar në lidhje me një aktiv ose një të drejtë që i është hequr ndërmarrjes së sigurimeve si përjashtim ndaj zbatimit të ligjit të Shtetit Anëtar të origjinës. Është mirë që pasojat që kanë këto masa dhe procedura tek masat e veçanta shtrënguese që rrjedhin nga këto procese gjyqësore të rregullohen nga legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës, sipas rregullit të përgjithshëm të kësaj direktive.

(27) Të gjithë personat të cilëve u kërkohet të marrin ose deklarojnë informacion në lidhje me procedurat e komunikimit të parashikuara në këtë direktivë duhet t'i nënshtrohet sekretit profesional në të njëjtën mënyrë si ajo e parashikuar në nenin 16 të Direktivës 92/49/KEE dhe nenin 15 të Direktivës 92/96/KEE me përjashtim të autoritetit gjyqësor për të cilin zbatohet legjislacioni specifik kombëtar.

(28) Për të vetmin qëllim të zbatimit të dispozitave të kësaj direktive për masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit në lidhje me degët që gjenden në Komunitet të një ndërmarrjeje sigurimesh zyra qendrore e së cilës gjendet në një vend të tretë, Shteti Anëtar i origjinës është mirë të përcaktohet si Shteti Anëtar në të cilin gjendet dega dhe autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet kompetente të përcaktohen si autoritetet e atij Shteti Anëtar.

(29) Nëse ka degë në më shumë se një Shtet Anëtar të një ndërmarrjeje sigurimesh, zyra qendrore e së cilës gjendet jashtë Komunitetit, secila degë duhet të trajtohet në mënyrë të pavarur për sa i takon zbatimit të kësaj direktive. Në këtë rast, autoritetet kompetente, autoritetet mbikëqyrëse, administratorët dhe likuidatorët duhet të përpiqen të bashkërendojnë veprimet e tyre,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

TITULLI I

FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Kjo direktivë zbatohet për masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve.

2. Kjo direktivë, zbatohet gjithashtu, për aq sa parashikohet në nenin 30, për masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit në lidhje me degët në territorin e Komunitetit të ndërmarrjeve të sigurimeve me zyra qendrore jashtë Komunitetit.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) "ndërmarrje sigurimi" është ndërmarrja që ka marrë autorizimin zyrtar në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 6 të Direktivës 79/267/KEE;

- (b) "degë" është çdo prani e përhershme e një ndërmarrjeje sigurimesh në territorin e Shtetit Anëtar, që nuk është Shteti Anëtar i origjinës, e cila kryen veprimtari sigurimesh;
- (c) "masa riorganizimi" janë masat në lidhje me një ndërhyrje të organeve administrative ose autoriteteve gjyqësore që synojnë të ruajnë ose të rivendosin gjendjen financiare të një ndërmarrjeje të sigurimeve dhe që prekin të drejtat e mëparshme të palëve me përjashtim të vetë ndërmarrjes së sigurimeve, duke përfshirë, ndër të tjera, masat që përfshijnë mundësinë e një pezullimi të pagesave, pezullimi të masave ekzekutive ose zvogëlimin e kërkesave për dëmshpërblim;
- (d) "procedurë likuidimi" është procedura kolektive që ka të bëjë me konvertimin në likuiditet të aktiveve të ndërmarrjes së sigurimeve dhe shpërndarjen e të hyrave nga shitja tek kreditorët, aksionarët ose anëtarët, sipas rastit, ku përfshihet domosdoshmërisht ndërhyrja e organeve administrative ose gjyqësore të një Shteti Anëtar, duke përfshirë rastet kur procedura kolektive pushohet me marrëveshje ose masë tjetër të ngjashme, pavarësisht nëse bazohet në paaftësi paguese apo nëse është e vullnetshme ose e detyrueshme.
- (e) "Shteti Anëtar i origjinës" është Shteti Anëtar ku është autorizuar ndërmarrja e sigurimeve në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE ose me nenin 6 të Direktivës 79/267/KEE;
- (f) "Shteti Anëtar pritës" është Shteti Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i origjinës, ku ndërmarrja e sigurimeve ka një degë;
- (g) "autoritete kompetente" janë autoritetet administrative ose gjyqësore të Shteteve Anëtare të cilët janë kompetente për qëllimet e masave të riorganizimit ose të procedurave të likuidimit;
- (h) "autoritete mbikëqyrëse" janë autoritetet kompetente brenda kuptimit të nenit 1 shkronja "k" të Direktivës 92/49/KEE dhe të nenit 1 shkronja "I" të Direktivës 92/96/KEE;
- (i) "administrator" është personi ose organi i caktuar nga autoritetet kompetente për qëllimet e administrimit të masave të riorganizimit;
- (j) "likuidator" është personi ose organi i emëruar nga autoritetet kompetente ose nga organet drejtuese të ndërmarrjes së sigurimeve, sipas rastit, për qëllimet e administrimit të procedurave të likuidimit;
- (k) "kërkesa për dëmshpërblim të sigurimeve" janë shumat me të cilat ndërmarrja e sigurimeve u detyrohet personave të siguruar, policëmbajtësve, përfituesve ose një pale tjetër të dëmtuar që ka të drejtën e drejtpërdrejtë të pretendojë kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve dhe që rrjedh nga një kontratë sigurimesh ose nga një operacion i parashikuar në nenin 1 pika 2 dhe 3 të Direktivës 79/267/KEE në veprimtarinë e sigurimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë shumat e hequra mënjanë për personat e sipërpërmendur, nëse disa elementë të borxhit nuk janë akoma të njohur. Primet me të cilat detyrohet ndërmarrja e sigurimeve si rezultat i mosnënshkrimit ose prishjes së këtyre kontratave të sigurimeve dhe operacioneve në përputhje me legjislacionin e zbatuar për këto kontrata ose operacione para hapjes së

procedurës së likuidimit konsiderohen gjithashtu si kërkesa për dëmshpërblim të sigurimeve

TITULLI II

MASAT E RIORGANIZIMIT

Neni 3

Objekti

Ky Titull zbatohet për masat e riorganizimit të përkufizuara në nenin 2 shkronja “c”.

Neni 4

Vendimi për masat e riorganizimit – legjislacioni i zbatueshëm

1. Vetëm autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës kanë të drejtën e vendimit për masat e riorganizimit në lidhje me një ndërmarrje sigurimesh, duke përfshirë degët e saj në Shtete të tjerë Anëtare. Masat e riorganizimit nuk përjashtojnë hapjen e procedurës së likuidimit nga Shteti Anëtar i origjinës.
2. Masat e riorganizimit rregullohen me aktet ligjore, nënligjore dhe me procedurat e zbatueshme në Shtetin Anëtar të origjinës, nëse nuk parashikohet ndryshe në nenet nga 19 deri në 26.
3. Masat e riorganizimit janë në fuqi të plotë në të gjithë Komunitetin në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar të origjinës pa formalitete të tjera, duke përfshirë edhe ato kundër palëve të treta në Shtete Anëtare të tjera, edhe nëse legjislacioni i Shteteve Anëtare të tjera nuk i parashikon këto masa riorganizimi ose ndryshe ua nënshtron zbatimin e tyre kushteve të cilat nuk janë përmbushur.
4. Masat e riorganizimit kanë fuqi në të gjithë Komunitetin menjëherë sapo të hyjnë në fuqi në Shtetin Anëtar ku janë marrë.

Neni 5

Informacioni për autoritetet mbikëqyrëse

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës informojnë menjëherë autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës për vendimin e tyre për masat e riorganizimit, sipas rastit para marrjes së vendimit për këtë masë ose përndryshe menjëherë pas kësaj. Autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare për vendimin për miratimin e masave riorganizuese duke përfshirë efektet e mundshme praktike të këtyre masave.

Neni 6

Publikimi

1. Nëse mund të bëhet ankim në Shtetin Anëtar të origjinës kundër masës së riorganizimit, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, administratori ose çdo person që ka të drejtë të bëjë këtë në Shtetin Anëtar të origjinës bën publik vendimin për masën e riorganizimit në përputhje me procedurat e publikimit të parashikuara në Shtetin Anëtar të origjinës dhe, për më tepër, publikon në rastin më të parë në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane një pjesë nga dokumenti me të cilin merret masa e riorganizimit. Autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare të cilat janë informuar për vendimin për masën e riorganizimit në përputhje me nenin 5 mund të sigurojnë publikimin e këtij vendimi brenda territorit të tyre në mënyrën që e konsiderojnë të përshtatshme.

2. Publikimi i parashikuar në pikën 1 specifikon edhe autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, legjislacionin e zbatueshëm sipas parashikimit në nenin 4 pika 2 dhe administratorin e emëruar, sipas rastit. Publikimi bëhet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit Anëtar në të cilin publikohet informacioni.

3. Masat e riorganizimit zbatohen pavarësisht dispozitave në lidhje me publikimin e parashikuar në pikën 1 dhe 2 dhe kanë fuqi të plotë kundrejt kreditorëve, nëse nuk parashikohet ndryshe nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës ose legjislacioni i atij Shteti.

4. Nëse masat e riorganizimit prekin vetëm të drejtat e aksionarëve, anëtarëve ose punonjësve të ndërmarrjes së sigurimeve, të marrë në këto cilësi, ky nen nuk zbatohet, nëse nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni i zbatueshëm për këto masa riorganizimi. Autoritetet kompetente vendosin mënyrën në të cilën palët e interesuara të prekura nga këto masa riorganizimi informohen në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 7

Informacioni për kreditorët e njohur - E drejta për të ngritur pretendime

1. Nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës kërkon ngritjen e një pretendimi me qëllim njohjen e tij ose parashikon njoftimin e detyrueshëm të një mase riorganizimi për kreditorët të cilët vendqëndrimin, vendbanimin ose zyrën qendrore e kanë në atë shtet, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës ose administratori njofton edhe kreditorët e njohur me vendqëndrim, vendbanim ose zyrë qendrore në një Shtet tjetër Anëtar, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 15 dhe nenin 17 pika 1.

2. Nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës parashikon të drejtën e kreditorëve me vendqëndrim, vendbanim ose zyra qendrore në atë Shtet të ngrenë pretendime ose të paraqesin vërejtje në lidhje me pretendimet e tyre, kreditorët me vendqëndrim, vendbanim ose zyra qendrore në një Shtet tjetër Anëtar kanë të njëjtën të drejtë për të ngritur pretendime ose paraqitur vërejtje në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 16 dhe nenin 17 pika 2.

TITULLI III

PROCEDURA E LIKUIDIMIT

Neni 8

Hapja e procedurës së likuidimit - Informacioni për autoritetet mbikëqyrëse

1. Vetëm autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës kanë të drejtën e vendimit për hapjen e procedurës së likuidimit në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve, duke përfshirë edhe degët e saj në Shtete të tjera Anëtare. Ky vendim mund të merret në mungesë të masave të riorganizimit ose pas zbatimit të tyre.
2. Vendimi i marrë në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar të origjinës në lidhje me hapjen e procedurës së likuidimit të ndërmarrjes së sigurimeve, duke përfshirë edhe degët në Shtete të tjera Anëtare, njihet pa formalitet tjetër brenda territorit të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare dhe ka fuqi zbatuese menjëherë sapo të ketë fuqi zbatuese në Shtetin Anëtar në të cilin hapet procedura.
3. Autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës informohen urgjentisht për vendimin e hapjes së procedurës së likuidimit, sipas rastit, para hapjes së procedurës, ose përndryshe menjëherë pas kësaj. Autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës informojnë urgjentisht autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare për vendimin për hapjen e procedurës së likuidimit duke përfshirë edhe efektet e mundshme në praktikë të kësaj procedure.

Neni 9

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Vendimi për hapjen e procedurës së likuidimit në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve, procedura e likuidimit dhe efektet e tyre rregullohen nga aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të Shtetit Anëtar të origjinës, nëse nuk parashikohet ndryshe në nenet nga 19 deri në 26.
2. Legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës përcakton veçanërisht:
 - (a) aktivet që përbëjnë pasurinë në likuidim dhe trajtimin e aktiveve që merr ndërmarrja e sigurimeve ose që i transferohen ndërmarrjes së sigurimeve pas hapjes së procedurës së likuidimit;
 - (b) kompetencat përkatëse të ndërmarrjes së sigurimeve dhe likuidatorit;
 - (c) kushtet me të cilat mund të bëhet kompensimi me të drejta i detyrimeve;
 - (d) efektet që ka procedura e likuidimit tek kontratat në fuqi në të cilat ndërmarrja e sigurimeve është palë;
 - (e) efektet që ka procedura e likuidimit tek proceset e çelura nga kreditorë individualë, me përjashtim të gjykimeve të papërfunduara të parashikuara në nenin 26.
 - (f) pretendimet që duhet të ngrihen ndaj pasurisë në likuidim të ndërmarrjes së sigurimeve dhe trajtimin e pretendimeve që dalin pas hapjes së procedurës së likuidimit;

- (g) rregullat që rregullojnë ngritjen, verifikimin dhe pranimin e pretendimeve;
- (h) rregullat që rregullojnë shpërndarjen e të hyrave nga konvertimi i aktiveve, renditjen e pretendimeve dhe të drejtat e kreditorëve të cilët kanë përfituar përmbushje të pjesshme pas hapjes së procedurës së likuidimit në bazë të një të drejte reale ose nëpërmjet një kompensimi;
- (i) kushtet dhe efektet për mbylljen e procedurës së likuidimit, veçanërisht me marrëveshje;
- (j) të drejtat e kreditorëve pas mbylljes së procedurës së likuidimit;
- (k) cili duhet të mbulojë koston dhe shpenzimet e lindura në procedurën e likuidimit;
- (l) rregullat në lidhje me pavlefshmërinë, kundërshtueshmërinë për pavlefshme ose mosekzekutueshmërinë e veprimeve juridike që dëmtojnë të gjithë kreditorët.

Neni 10

Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që kërkesat për dëmshpërblim të sigurimeve të kenë përparësi kundrejt pretendimeve të tjera ndaj një ndërmarrjeje sigurimesh sipas njëres ose të dyjave metodave të mëposhtme:

- (a) kërkesat për dëmshpërblim të sigurimeve, në lidhje me aktivet që përfaqësojnë provigjonet teknike, kanë përparësi absolute kundrejt çdo pretendimi tjetër ndaj ndërmarrjes së sigurimeve;
- (b) kërkesat për dëmshpërblim të sigurimeve, në lidhje me të gjitha aktivet e ndërmarrjes së sigurimeve, kanë përparësi kundrejt çdo pretendimi tjetër ndaj ndërmarrjes së sigurimeve me të vetmin përjashtim të mundshëm të:
 - (i) pretendimeve të punonjësve që rrjedhin nga kontratat e punës dhe marrëdhëniet e punës,
 - (ii) pretendimeve të organeve publike në lidhje me tatimet,
 - (iii) pretendimeve të sistemeve të sigurimeve shoqërore,
 - (iv) pretendimeve mbi aktivet që u nënshtrohen të drejtave reale.

2. Pa cenuar pikën 1, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që të gjitha ose një pjesë e shpenzimeve që rrjedhin nga procedura e likuidimit, sipas përkufizimit në legjislacionin e tyre të brendshëm, të kenë përparësi kundrejt kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve.

3. Shtetet Anëtare që kanë zgjedhur metodën e parashikuar në pikën 1 shkronja “a” u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimeve të vendosin dhe të mbajnë të përditësuar një regjistër në përputhje me dispozitat e parashikuara në shtojcë.

Neni 11

Transferimi tek një skemë garancie

Shteti Anëtar i origjinës mund të parashikojë që nëse të drejtat e kreditorëve të sigurimeve u janë transferuar në skemë garancie të ngritur në këtë Shtet Anëtar të origjinës pretendimet nga kjo skemë të mos përfitojnë nga dispozitat e nenit 10 pika 1.

Neni 12

Mbulimi me aktive i pretendimeve me përparësi

Në shmangie të nenit 19 të Direktivës 73/239/KEE dhe nenit 21 të Direktivës 79/267/KEE, Shtetet Anëtare që zbatojnë metodën e parashikuar në nenin 10 pika 1 shkronja “b” të kësaj direktive i kërkojnë çdo ndërmarrjeje të sigurimeve që, në çdo moment dhe pavarësisht nga një likuidim i mundshëm, të mbulojnë pretendimet që kanë përparësi kundrejt kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve në përputhje me nenin 10 pika 1 shkronja “b” dhe që janë regjistruar në llogaritë e ndërmarrjes së sigurimeve, me aktivet e përmendura në nenin 21 të Direktivës 92/49/KEE dhe nenin 21 të Direktivës 92/96/KEE.

Neni 13

Tërheqja e autorizimit

1. Kur në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve vendoset hapja e procedurës së likuidimit, autorizimi i ndërmarrjes së sigurimeve revokohet, nëse nuk është revokuar më parë, me përjashtim për atë që është e nevojshme të zbatohet pika 2, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 22 të Direktivës 73/239/KEE dhe nenin 26 të Direktivës 79/267/KEE.
2. Revokimi i autorizimit në përputhje me pikën 1 nuk e pengon likuidatorin ose një person tjetër të ngarkuar nga autoritetet kompetente të zhvillojë disa nga veprimtaritë e ndërmarrjes së sigurimeve për atë që është e nevojshme ose e përshtatshme për qëllimet e likuidimit. Shteti Anëtar i origjinës mund të parashikojë që këto veprimtari të zhvillohen me pëlqimin dhe nënmbikëqyrjen e autoriteteve mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës.

Neni 14

Publikimi

1. Autoriteti kompetent, likuidatori ose një person i caktuar për këtë qëllim nga autoriteti kompetent publikon vendimin për hapjen e procedurës së likuidimit në përputhje me procedurat e publikimit të parashikuara në Shtetin Anëtar të origjinës dhe publikon një pjesë nga vendimi i likuidimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane. Autoritetet mbikëqyrëse të të gjitha Shteteve të tjera Anëtare të cilat janë informuar për vendimin për hapjen e procedurës së likuidimit në përputhje me nenin 8 pika 3 mund të sigurojnë publikimin e këtij vendimi brenda territoreve të tyre në mënyrën që e konsiderojnë të përshtatshme.
2. Publikimi i vendimit për hapjen e procesit të likuidimit të parashikuar në pikën 1 specifikon gjithashtu autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, legjisllacionin e

zbatueshëm dhe likuidatorin e caktuar. Publikimi bëhet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit Anëtar në të cilin publikohet informacioni.

Neni 15

Informimi i kreditorëve të njohur

1. Me hapjen e procedurës së likuidimit, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, likuidatori ose çdo person i caktuar për këtë qëllim nga autoritetet kompetente informojnë pa vonesë për këtë, individualisht me njoftim me shkrim çdo kreditor të njohur i cili e ka vendbanimin kryesor ose zyrën qendrore në një Shtet tjetër Anëtar.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 trajton veçanërisht afatet kohore, gjobat e vendosura në lidhje me këto afate kohore, organin ose autoritetin që ka kompetencën të pranojë paraqitjen e pretendimeve ose vërejtjeve në lidhje me pretendimet dhe masat e tjera të parashikuara. Njoftimi tregon gjithashtu nëse kreditorët pretendimet e të cilëve kanë përparësi ose janë të garantuara si të drejta reale duhet të paraqesin pretendimet e tyre. Në rastin e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve, njoftimi tregon gjithashtu efektet e përgjithshme të procedurës së likuidimit për kontratat e sigurimeve, veçanërisht, datën më të cilën kontratat e sigurimeve ose operacionet pushojnë së prodhuari efektet dhe të drejtat dhe detyrimet e personave të siguruar në lidhje me kontratën ose operacionin.

Neni 16

E drejta për paraqitjen e pretendimeve

1. Çdo kreditor me vendbanim kryesor ose zyrë qendrore në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i origjinës, duke përfshirë edhe autoritetet publike të Shteteve Anëtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendime ose vërejtje me shkrim në lidhje me pretendimet.

2. Pretendimet e të gjithë kreditorëve me vendqëndrim, vendbanim ose zyra qendrore në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i origjinës, duke përfshirë edhe autoritetet e sipërpërmendura, trajtohet në të njëjtën mënyrë dhe u jepet e njëjta përparësi me pretendimet e një natyre të barasvlershme që mund të paraqiten nga kreditorët me vendqëndrim, vendbanim ose zyra qendrore në Shtetin Anëtar të origjinës.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe në legjislacionin e Shtetit Anëtar të origjinës, kreditori dërgon kopje të dokumenteve mbështetëse, sipas rastit, dhe tregon natyrën e pretendimit, datën më të cilën ka lindur e drejta dhe shumën, nëse kërkon trajtim me përparësi të pretendimit, garancinë e së drejtës reale ose rezervimin e titullit në lidhje me pretendimin dhe cilat aktive mbulohen nga kjo garanci. Përparësi që u jep e kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve të neni 10 nuk është e nevojshme të tregohet.

Neni 17

Gjuha dhe forma

1. Informacioni në njoftimin e përmendur në nenin 15 jepet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të Shtetit Anëtar të origjinës. Për këtë qëllim përdoret një formular që ka titullimin "Ftesë për paraqitjen pretendimit; afatet kohore që duhet të respektohen" ose, nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës parashikon paraqitjen e vërejtjeve në lidhje me pretendimet, ka titullin "Ftesë për paraqitjen e vërejtjeve në lidhje me pretendimin; afatet kohore që duhet të respektohen", në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian.

Megjithatë, nëse një kreditor i njohur është zotërues i një kërkesë për dëshmipërblim sigurimesh, informacioni në njoftimin e përmendur në nenin 15 jepet në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shteteve Anëtare ku kreditori ka vendbanimin e përhershëm ose zyrën qendrore.

2. Çdo kreditor me vendbanimin e përhershëm ose zyrën qendrore në një Shtet Anëtar, që nuk është Shteti Anëtar i origjinës, mund të paraqesë pretendimin ose vërejtjet e tij në lidhje me pretendimin e tij në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të atij Shteti Anëtar tjetër. Megjithatë, në atë rast paraqitja e pretendimit ose vërejtjeve të tij për pretendimin, sipas rastit, mban titullin "Paraqitja e pretendimit" ose "Paraqitja e vërejtjeve në lidhje me pretendimet", sipas rastit në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit Anëtar të origjinës.

Neni 18

Informimi i rregullt i kreditorëve

1. Likuidatorët i mbajnë kreditorët të informuar rregullisht, në një mënyrë të përshtatshme, veçanërisht në lidhje me ecurinë e likuidimit.

2. Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare mund të kërkojnë informacion mbi zhvillimet në procedurën e likuidimit nga autoritetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar të origjinës.

TITULLI IV

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR MASAT E RIORGANIZIMIT DHE
PROCEDURËN E LIKUIDIMIT

Neni 19

Efektet mbi kontrata dhe të drejta të caktuara

Në shmangie të neneve 4 dhe 9, efektet që ka fillimi i masave të riorganizimit ose i procedurës së likuidimit tek kontratat dhe të drejtat e specifikuar më poshtë rregullohen nga rregullat e mëposhtëm:

(a) kontratat e punës dhe marrëdhëniet e punës rregullohen vetëm nga legjislacioni i Shtetit Anëtar që zbatohet për kontratën dhe marrëdhëniet e punës;

(b) kontrata që jep të drejtën e përdorimit ose të marrjes në pronësi të pasurisë së paluajtshme rregullohet vetëm nga legjislacioni i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit gjendet pasuria e paluajtshme;

(c) të drejtat e ndërmarrjes së sigurimeve në lidhje me pasurinë e paluajtshme, mjetin detar ose mjetin ajror që i nënshtrohet regjistrimit në një regjistër publik rregullohet nga legjislacioni i Shtetit Anëtar pranë autoritetit të të cilit mbahet regjistri.

Neni 20

Të drejtat reale të palëve të treta

1. Fillimi i masave të riorganizimit ose i procedurës së likuidimit nuk ndikon mbi të drejtat reale të kreditorëve ose të palëve të treta në lidhje me aktivet afatgjata materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme - si aktivet specifike ashtu edhe grupet e aktiveve të papërcaktuara si të tëra, të cilat ndryshojnë herë pas here, të cilat i takojnë ndërmarrjes së sigurimeve dhe të cilat gjenden brenda territorit të një Shteti tjetër Anëtar në momentin e fillimit të këtyre masave ose procedurave.

2. Të drejtat e përmendura në pikën 1 janë veçanërisht:

(a) e drejta për të hequr aktivet dhe për të shlyer detyrimet me të ardhurat e këtyre aktiveve, veçanërisht përmes pengut ose barrës hipotekare;

(b) e drejta ekskluzive për përfitimin e përmbushjes së pretendimit, veçanërisht të një të drejte të garantuar me peng në lidhje me një pretendim ose me transferim pretendimit në formën e një garancie;

(c) e drejta e kërimit të aktiveve dhe/ose e kërimit të rikthimit nga cilido që i zotëron ose i përdor ato në kundërshtim me dëshirat e palës që ka këtë të drejtë;

(d) e drejta reale për marrjen e përfitimeve të aktiveve.

3. E drejta e regjistruar në një regjistër publik dhe e ekzekutueshme kundrejt palëve të treta nga e cila mund të përftohet një e drejtë reale në kuptimin e pikës 1 konsiderohet një e drejtë reale.

4. Pika 1 nuk cenon kërkimin e pavlefshmërisë, kundërshtueshmërisë ose mosekzekutueshmërisë të përmendur në nenin 9 pika 2 shkronja "1".

Neni 21

Ruajtja e titullit

1. Fillimi i masave të riorganizimit ose procedurës së likuidimit kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve që blen një aktiv nuk cenon të drejtat e shitësit bazuar në rezervimin e titullit nëse në momentin e fillimit të këtyre masave ose procedure aktivi gjendet në territorin e një Shteti Anëtar që nuk është Shteti ku kanë filluar këto masa ose procedura.

2. Fillimi i masave të riorganizimit ose procedurës së likuidimit kundrejt ndërmarrjes së sigurimeve që shet një aktiv, pas dorëzimit të aktivit, nuk përbën shkak për kthimin ose ndërprerjen e shitjes dhe nuk e pengon blerësin të marrë titullin nëse në momentin e fillimit të këtyre masave ose procedurave aktivi i shitur gjendet në territorin e një Shteti Anëtar që nuk është Shteti ku fillojnë këto masa ose procedura.

3. Pikat 1 dhe 2 nuk cenojnë kërkimin e pavlefshmërisë, kundërshtueshmërisë ose mosekzekutueshmërisë të përmendur në nenin 9 pika 2 shkronja “l”.

Neni 22

Kompensimi

1. Fillimi i masave të riorganizimit ose procedurës së likuidimit nuk cenon të drejtën e kreditorëve për të kërkuar kompensimin e pretendimeve të tyre me pretendimet e ndërmarrjes së sigurimeve, nëse një kompensim i tillë lejohet nga legjislacioni i zbatueshëm për pretendimin e ndërmarrjes së sigurimeve.

2. Pika 1 nuk cenon kërkimin e pavlefshmërisë, kundërshtueshmërisë ose mosekzekutueshmërisë të përmendur në nenin 9 pika 2 “l”.

Neni 23

Tregjet e rregulluara

1. Pa cenuar nenin 20, efektet që ka masa e riorganizimit ose fillimi i procedurës së likuidimit tek të drejtat dhe detyrimet e palëve në një treg të rregulluar rregullohen vetëm nga legjislacioni i zbatueshëm për atë treg.

2. Pika 1 nuk cenon kërkimin e pavlefshmërisë, kundërshtueshmërisë ose mosekzekutueshmërisë të përmendur në nenin 9 pika 2 “l” i cili mund të ndërmerret për të shpallur të pavlefshme pagesat ose veprimet juridike sipas legjislacionit të zbatueshëm për atë treg.

Neni 24

Veprimet dëmtuese

Neni 9 pika 2 “l” nuk zbatohet nëse personi i cili ka përfituar nga një veprim juridik dëmtues për të gjithë kreditorët e tjerë jep prova që:

(a) ky veprim i nënshtrohet legjislacionit të një Shteti Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i origjinës dhe,

(b) legjislacioni i përmendur në germën “a” nuk lejon asnjë mjet të kundërshtimi të atij veprimi në rastin përkatës.

Neni 25

Mbrojtja e blerësve si palë të treta

Nëse nëpërmjet një veprimi të përfunduar pas zbatimit të një mase riorganizimi ose fillimit të procedurës së likuidimit, ndërmarrja e sigurimeve heq, kundrejt një pagese:

(a) një aktiv të paluajtshëm,

(b) një mjet lundrimi ose mjet ajror që i nënshtrohet regjistrimit në një regjistër publik ose

(c) letra me vlerë të transferushme, ose letra të tjera me vlerë, ekzistenca ose transferimi i të cilave presupozon regjistrimin në një regjistër, ose llogari të parashikuar me ligj, ose që mbahen për një sistem qendror depozitimi të rregulluar me ligjin e një Shteti Anëtar,

vlefshmëria e atij veprimi rregullohet nga legjislacioni i Shtetit Anëtar në territorin e të cilit gjendet aktivi i paluajtshëm ose pranë autoritetit të të cilit mbahet regjistri, llogaria ose sistemi.

Neni 26

Gjykimet e papërfunduara

Efektet që kanë masat e riorganizimit ose procedurat e likuidimit tek një gjykim i papërfunduar në lidhje me një aktiv ose të drejtë që i është hequr ndërmarrjes së sigurimeve rregullohen vetëm nga legjislacioni i Shtetit Anëtar në të cilin ka filluar gjykimi.

Neni 27

Administratorët dhe likuidatorët

1. Emërimi i administratorit ose likuidatorit provohet me një kopje të vërtetuar të vendimit origjinal që e emëron atë ose me një vërtetim tjetër të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës.

Mund të kërkohet një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit dëshiron të veprojë administratori ose likuidatori. Nuk kërkohet legalizim apo ndonjë formalitet tjetër i ngjashëm.

2. Administratorët dhe likuidatorët kanë të drejtë të ushtrojnë në territorin e të gjithë Shteteve Anëtare të gjitha kompetencat që ata kanë të drejtë të ushtrojnë në territorin e Shtetit Anëtar të origjinës. Mund të emërohen persona për të asistuar ose, sipas rastit, për të përfaqësuar administratorët dhe likuidatorët, në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar të origjinës, në kuadrin e masave të riorganizimit ose likuidimit, veçanërisht në Shtetet Anëtare pritëse dhe, veçanërisht, me qëllim që të ndihmojnë në kalimin e çdo vështirësie që hasin kreditorët në Shtetin Anëtar pritës.

3. Në ushtrim të kompetencave të tij në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar të origjinës, administratori ose likuidatori respekton legjislacionin e Shteteve Anëtare në territorin e të cilëve dëshiron të veprojë, veçanërisht, në lidhje me procedurat për konvertimin e aktiveve dhe informimin e punonjësve. Këto kompetenca nuk mund të përfshijnë

përdorimin e forcës ose të drejtën e vendimmarrjes për procedimet ose mosmarrëveshjet juridike.

Neni 28

Regjistrimi në një regjistër publik

1. Administratori, likuidatori ose një autoritet ose person tjetër me kompetenca të dhëna në mënyrë të rregullt në Shtetin Anëtar të origjinës mund të kërkojë që masa e riorganizimit ose vendimi për hapjen e procedurës së likuidimit të regjistrohet në regjistrin e tokës, regjistrin tregtar dhe çdo regjistër tjetër publik që mbajnë Shtetet e tjera Anëtare.

Megjithatë, nëse një Shtet Anëtar kërkon regjistrim të detyrueshëm, autoriteti ose personi i përmendur në paragrafin e parë merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar këtë regjistrim.

2. Kostoja e regjistrimit konsiderohet si kosto dhe shpenzim i lindur në procedurë.

Neni 29

Sekreti profesional

Të gjithë personat të cilëve u kërkohet të marrin ose deklarojnë informacion në lidhje me procedurat e komunikimit në parashikuara në nenin 5, 8 dhe 30 janë objekt i sekretit profesional në të njëjtën mënyrë si ajo e parashikuar në nenin 16 të Direktivës 92/49/KEE dhe nenin 15 të Direktivës 92/96/KEE me përjashtim të autoriteteve gjyqësore për të cilat zbatohen dispozitat specifike kombëtare.

Neni 30

Degët e ndërmarrjeve të sigurimeve të vendeve të treta

1. Pavarësisht përkufizimeve të parashikuara në nenin 2 shkronjat "e", "f" dhe "g" dhe me qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj direktive për masat e riorganizimit dhe procedurat e likuidimit në lidhje me një degë që gjendet në një Shtet Anëtar të një ndërmarrjeje sigurimesh që e ka zyrën qendrore jashtë Komunitetit:

(a) "Shtet Anëtar i origjinës" është Shteti Anëtar në të cilin dega ka marrë autorizimin zyrtar në përputhje me nenin 23 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 27 të Direktivës 79/267/KEE dhe

(b) "autoritete mbikëqyrëse" dhe "autoritete kompetente" janë ato autoritete të Shtetit Anëtar në të cilin është autorizuar dega.

2. Nëse ndërmarrja e sigurimeve me zyrë qendrore jashtë Komunitetit ka degë të vendosura në më shumë se një Shtet Anëtar, secila degë trajtohet në mënyrë të pavarur në lidhje me zbatimin e kësaj direktive. Autoritetet kompetente dhe autoritetet mbikëqyrëse të këtyre Shteteve Anëtare bëjnë përpjekje për të bashkërenduar veprimet e tyre. Edhe gjithë administratorët ose likuidatorët bëjnë përpjekje për të bashkërenduar veprimet e tyre.

Neni 31

Zbatimi i kësaj direktive

1. Shtetet Anëtare miratojnë aktet ligjore, nënljgore dhe administrative të nevojshme për të përmbushur këtë direktivë brenda datës 20 prill 2003. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Shtetet Anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen kësaj direktive ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Metodatat e bërjes së një reference të tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Dispozitat kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj direktive zbatohen vetëm për masat e riorganizimit ose procedurat e likuidimit të miratuara ose të filluara pas datës së përmendur në pikës 1. Masat e riorganizimit të miratuara ose procedurat e likuidimit të filluara para asaj date vazhdojnë të rregullohen nga ligji që ka qenë i zbatueshëm për to në momentin e miratimit ose fillimit.

3. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme që miratojnë në fushën që rregullon kjo direktivë.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 33

Të adresuarit

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 19 mars 2001.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

N. Fontanie

Për Këshillin

Presidenti

A. Lindh

(1) GZ C 71, 19.3.1987, fq. 5, dhe

[2] GZ C 253, 6.10.1989, fq. 3.

[2] GZ C 319, 30.11.1987, fq. 10.

(3) Opinioni i Parlamentit Europian, datë 15 mars 1989 (GZ C 96, 17.4.1989, fq. 99), konfirmuar më 27 tetor 1999, Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 9 tetor 2000 (GZ C 344, 1.12.2000, fq. 23) dhe Vendimi i Parlamentit Europian datë 15 shkurt 2001.

[4] GZ L 228, 16.8.1973, fq. 3. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga direktiva e Parlamentit Europian dhe Këshillit 95/26/KE (GZ L 168, 18.7.1995, fq. 7).

(5) Direktivë e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 73/239/KEE dhe 88/357/KEE (direktiva e tretë për sigurimin e jo-jetës)(GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1).

[6] GZ L 63, 13.3.1979, fq. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 95/26/KE.

(7) Direktivë e Këshillit 92/96/KEE, datë 10 nëntor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 79/267/KEE dhe 90/619/KEE (direktiva e tretë për sigurimin e jetës) (GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1).

[8] GZ L 160, 30.6.2000, fq. 1.

SHTOJCË

REGJISTRI I VEÇANTË I PËRMENDUR NË NENIN 10 PIKA 3

1. Çdo ndërmarrje sigurimesh duhet të mbajë në zyrën qendrore një regjistër të veçantë të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike të llogaritura dhe të investuara në përputhje me rregullat e Shtetit Anëtar të origjinës.
2. Nëse ndërmarrja e sigurimeve ushtron veprimtari të sigurimeve jo jetë dhe jetë, duhet të mbajë në zyrën qendrore regjistra të veçantë për secilin lloj veprimtarie. Megjithatë, nëse Shteti Anëtar autorizon ndërmarrjet e sigurimeve të mbulojnë jetën dhe risqet e renditura në pikat 1 dhe 2 të shtojcës A të Direktivës 73/239/KEE, ai mund të parashikojë që këto ndërmarrje sigurimesh të mbajnë një regjistër të vetëm për të gjitha veprimtaritë e tyre.
3. Vlera gjithsej e aktiveve të regjistruara, dhe të vlerësuara në përputhje me rregullat e zbatueshme në Shtetin Anëtar të origjinës, asnjëherë nuk duhet të jenë më pak se vlera e provigjoneve teknike.
4. Nëse një aktiv i regjistruar në regjistër i nënshtrohet një të drejte reale në favor të një kreditori ose një pale të tretë, çka bën që kjo pjesë e vlerës së aktivit të mos mund të përdoret për mbulimin e angazhimeve, ky fakt regjistrohet në regjistër dhe shuma që nuk është e disponueshme nuk përfshihet në vlerën e plotë të përmendur në pikën 3.

5. Nëse një aktiv që përdoret për të mbuluar provigjonet teknike i nënshtrohet një të drejte reale në favor të një kreditori ose një pale të tretë, pa përmbushur kushtet e pikës 4, ose nëse një aktiv i tillë i nënshtrohet ruajtjes së titullit në favor të një kreditori ose një pale të tretë ose nëse një kreditor ka të drejtë të kërkojë kompensimin e pretendimit të tij kundrejt pretendimit të ndërmarrjes së sigurimeve, trajtimi i këtij aktivi në rastin e likuidimit të ndërmarrjes së sigurimit në lidhje me metodën e parashikuar në nenin 10 pika 1 shkronja “a” përcaktohet nga legjislacioni i Shtetit Anëtar të origjinës përveç kur për aktivin zbatohen nenet 20, 21 ose 22.

6. Përbërja e aktiveve pasurore të regjistruara në regjistër në përputhje me pikat nga 1 deri në 5 në momentin kur fillon procedura e likuidimit nuk duhet të ndryshohet dhe asnjë ndryshim përveç korrigjimit të gabimeve thjesht teknike nuk duhet të bëhet në regjistra, përveç se me autorizimin e autoritetit kompetent.

7. Pavarësisht pikës 6, likuidatorët duhet t'u shtojnë këtyre aktiveve fitimet që lindin prej tyre dhe vlerën e primeve neto të arkëtuara në lidhje me kategorinë e veprimtarisë përkatëse që nga koha e fillimit të procedurës së likuidimit deri në momentin e pagesës së kërkesave për dëmshpërblim të sigurimeve ose deri në realizimin e çdo transferimi të portofolit.

8. Nëse produkti i konvertimit të aktiveve është më i vogël se vlera e tyre e çmuar në regjistër, likuidatorit duhet t'i kërkojë ta justifikojë këtë para autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës.

9. Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare duhet të marrin masat e përshtatshme për të siguruar zbatimin e plotë nga të gjithë ndërmarrjet e sigurimeve të dispozitave të kësaj shtojce.